

Bashkia: VLORË

Kryetar: DRITAN LELI

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Do të pajisen me dokument pronësie banorët e fshatrave për shtëpitë e tyre
2. Do të ndërhyet në infrastrukturën rrugore për të lidhur të gjithë fshatrat që tashmë bëjnë pjesë në territorin e ri të Bashkisë Vlorë.
3. Do të organizohet një grup ekspertësh me përvojë për zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë zonën rurale
4. Çdo lagje e Vlorës do të ketë studimin e saj urbanistik
5. Do të ndryshojë harta e shërbimit urban duke përfshirë një zonë shumë më të gjerë se kjo ekzistuese, duke rritur numrin dhe cilësia e mjeteve të transportit, përpikmërinë në orare, uniformë përkatëse për drejtuesit e mjeteve, ky shërbim do fillojë shumë më herët në mëngjes sesa bëhet sot dhe do rishikohen trajektorët e lëvizjeve që të kenaqen nevojat e qytetarëve, sidomos në arritjen e shkollave
6. Do të kryhet realizimi i një harte dighitale ku të mund të pasqyrohet prona e secilit prej banorëve, si një nga projektet primare që bashkia do të realizojë në bashkërendim me qeverinë
7. Do të zhduket koncepti i periferisë dhe do të krijohej një lidhje urbane
8. Do të zgjidhet problemi i ujit të pijshëm në territorin e bashkisë dhe banorët do të furnizohen 24 orë me ujë
9. Do të zgjidhet problemi me kanalizimet e ujërave të zeza dhe të ujërave të bardha në territorin e bashkisë
10. Do të shtohet ndriçimi dhe gjelbërimi në të gjithë Vlorën
11. Do të kryhen investime në infrastrukturën e brendshme të lagjeve të Vlorës
12. Do të kryhet rregullimi i rrugëve në territorin e bashkisë, si dhe rikonceptimi i tyre duke krijuar korsi për biçikleta
13. Do të kryhet kursimi i energjisë duke mbështetur bizneset që përdorin panele e duke përdorur ndriçimin LED për rrugët, i cili kursen 60 herë më shumë në raport me ndriçimin normal
14. Do të miratohet plani rregullës për bashkinë e madhe të Vlorës
15. Do të disiplinohet qarkullimi i automjeteve dhe parkimi në territorin e bashkisë
16. Do të shkurtohen daljet në bregdet për fshatrat në periferi të Vlorës
17. Do të kryhet zgjidhje përfundimtare e problemit të energjisë elektrike deri në fund të qershorit
18. Do të synohet zbatimi i projektit të aeroportit në Vlorë
19. Do punohet për ndërtimin e banesave të reja në zonën e ish Kampit të Pinorëve, ku të strehohen shumë nga familjet që prej dy dekadash jetojnë në kushte të vështira
20. Do të përfundohet rruga "Transballkanike" me trotuare, gjelbërim dhe ndriçim

21. Do të përfundojë Bypass i ri
22. Do të sistemohen sheshet, rrugët, trotualet dhe e gjithë infrastruktura e brendshme e qytetit
23. Në Rajonin 3 do të kryhet rigjallërim urbanistik, rregullim i segmenteve rrugore ekzistuese, shtrimi i rrugëve të reja që lidhin banesat e qytetarëve me rrugët kryesore, krijimi i hapësirave të gjelbërta dhe sistemimi i ndriçimit
24. Do të rikonstruktohet lulishtja e "3 Racave" në Rajonin Nr. 3
25. Do të përfundojë rruga në zonën "Fusha e Druve"
26. Do të përmirësohet transporti në zonën "Fusha e Druve"
27. Do të sigurohet ujë i pijshëm në zonën "Fusha e Druve"
28. Do të kryhet, në konsultim me tregtarët dhe kërkesat e tyre, por edhe në konsultim me qytetarët, sistemimi dhe organizimi në mënyrë sa më dinjitoze dhe civile i tregut të gjësë së gjallë në Rajonit Nr.5
29. Do të kryhet rikonstruksioni i rrugës së spitalit
30. Do të synohet ndërtimi i aksit rrugor që të çon te "Fabrika e Çimentos", zgjerimi i kësaj rruge me standarde bashkëkohorë, rregullimi i urës, krijimi i një zone banimi me ambiente të sistemuara, kanalizimi i ujërave, si dhe pastrimi e gjelbërimi i territorit në Rajonin Nr.1
31. Do të rikonstruktohet zona në Rajonin Nr. 2, "Çentrale"
32. Do të kryhen investime ne 8 akse kryesore të qytetit
33. Do të ndërtohet Lungomare
34. Do të rinovohet lagjia Muradie dhe rruga Justin Godart
35. Do të ndërtohet Terminali i transportit të qytetit
36. Do të vendosen tabela orientuese për majat e maleve, shtigjet, monumentet natyrore e kulturore në Dukat
37. Do të zgjidhet problemi i ujit në Dukat
38. Do të kryhet çertifikimi i pronave në Dukat
39. Do të zgjidhet problemi i ujit në Tragjas
40. Do të përmirësohet infrastruktura rrugore në Tragjas
41. Në Orikum do të kryhen përmirësime të ambienteve për moshën e tretë si dhe rehabilitim i rrugëve të brendshme të qytetit dhe fshatit
42. Do të kryhet ndërtimi dhe vënia në zbatim të projektit të tharjes së kenetës në Orikum
43. Do të kryhet rruga për në Kishën e Marmiroit
44. Do të kryhet planifikim i saktë i territorit, me ndryshime të mëdha në infrastrukturë, përfshirë këtu edhe kalimin e bypass-it që do ta shndërrojë Babicën e sotme në një zonë urbane
45. Në Babicë do të ketë zhvillim, vlerësim më të madh të pasurive të patundshme, rritje të madhe të tregtisë dhe të sektorit të shërbimeve, iniciativa të reja biznesi në përshtatje me realitetin e ri
46. Do të rikonstruktohet infrastruktura rrugore dhe do të vendoset ndriçim në Kaninë
47. Do të zgjidhet problemi i ujit në Kaninë

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

1. Do të zhvillohen më shumë hapësira të gjelbra dhe parqe publike në territorin e bashkisë ku të luajnë fëmijët
2. Në vitet e para këtij mandati do të shtohet numri i çerdheve fillimisht e më pas të shkollave në territorin e bashkisë për t'u përgjigjur edhe ndryshimeve demografike, të cilat kanë rritur nevojën e shtimit të këtyre institucioneve
3. Do të mbështeten projekte për edukimin e fëmijëve në shkolla, duke ndërthurur vlerat ambientale me ato kulturore
4. Do të përmirësohen kushtet në kopshte dhe çerdhe në territorin e bashkisë
5. Do të ndërtohen kape verore për fëmijët në të gjithë Vlorën
6. Do të rihapet pishina sportive e notit
7. Do të organizohen evente sportive ndërkombëtare
8. Flamurtarin do ta bëhet kampion
9. Do të organizohet Festvali Folklorik Mesdhetar
10. Do të mbështeten nxënësit dhe studentët e shkëlqyer
11. Do të ndërtohen laborator të specializuar në shkolla në territorin e bashkisë
12. Do të ndërtohet kinemaja e Vlorës
13. Do të ndërtohet qendra kulturore për fëmijët dhe terrene sportive në territorin e bashkisë
14. Do të promovohen festat e të gjithë krahinave të tjera, duke bërë një pelegrinazh turistik
15. Do të ndërtohet stadium i ri në afërsi të Pyllit të Sodës
16. Do të kryhen investimeve në fushën arsimore, duke krijuar biblioteka, laboratore, sistem ngrohje, palestra dhe ambiente komode për të gjitha shkollat e Orikutit

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Premtime:

1. Do të zhvillohet ekoturizmi në Nartë
2. Bashkia do të ketë nje faqe interneti ku përveç shërbimeve dhe informacioneve do të ketë një vend të rëndësishëm turizmi, i shfaqur në disa forma: 1. Ekoturizmi; 2. Turizmi Bed & Brekfast; 3. Agroturizmi
3. Do të ngrihen qendra informacioni në pika të ndryshme të qytetit, si dhe do të organizohet një guidë me monumente kulture dhe monumente natyre, ku të jepen edhe harta e trajektore udhëtimi në zonat e bashkisë, por edhe më tutje
4. Do të kryhet forcimi i policisë bashkiake në mbrojtje të pyjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave
5. Do të kryhet pastrimi i mbeturinave në menyrë më efëcente, sidomos gjatë sezonit turistik kur shtohet numri i banorëve të qytetit
6. Do të kryhet ndarja në mbeturina plastike, letre, xhami dhe organike në territorin e bashkisë si nismë e një projekti pilot
7. Do të kryhet krijimi i një landfilli të ri dhe pyllëzimi i landfilleve ekzistuese
8. Do të ngrihen Zyra Turistike në të gjitha qendrat rajonale
9. Do të vendoset në punë impjanti i ujërave të zeza
10. Do të ndalohet kategorikisht djegia e mbeturinave në territorin e Bashkisë Vlorë

11. Do të ndalohet derdhja e ujërave të zeza në det dhe janë evidentuar 18 pika që shërbejnë si grykëderdhje, çka do të shmangë ndotjen e detit
12. Sezoni turistik nuk do jetë vetëm 45 ditë por do të jetë 365 ditë
13. Do të ndërtohet parku i ri në Pyllin e Sodës
14. Të shndërrohet Sazani dhe Karaburuni në një pikë të rëndësishme për turizimin
15. Do të shndërrohen në destinacione të mirfillta turistike me gjithë infrastrukturën që i nevojitet Oriku i Vjetër, Kalaja e Kaninës dhe Ishulli i Zvërnecit
16. Do të gjelbërohen hapësirat e lira dhe do të pyllzohet kurora e qytetit të Vlorës
17. Do të punohet në mbështetjen me projekte dhe do të krijohen të gjitha lehtësitë për realizimin e tyre, si dhe do të llobohet për të siguruar financimet e mundshme në Oriku për ta shndërruar në një zonë me përparësi turistike; një zhvillim turistik i jashtëzakonshëm që do të sjellë hapjen e shumë vendeve të reja pune në këtë sektor, por edhe të ardhura të mëdha për banorët
18. Bashkia e re do të mundësojë në webfaqen e saj informacion për çdo shtëpi dukatase që ofron dhoma për pushues
19. Do t'i kushtohet rëndësi e veçantë marketingut turistik për promovimin e Zvërnecit dhe zonave të tjera bredgetare të Vlorës për të bërë të mundur shtimin e të ardhurave për banorët

Fusha: BUJQËSI

Premtime:

1. Do të zbatohet strategjia për prodhimet Made in Vlora, që u vjen në ndihmë fermerëve e bujqëve të zonës, duke siguruar tregje të reja dhe marketing bashkëkohor
2. Do të mbështetet zhvillimi i kultivimit të bimëve mjekësore në tokat e pakultivuara deri tani
3. Do të përmirësohet infrastruktura e mbrojtjes së tokave me sisteme kulluese dhe vaditëse
4. Do të nxitet prodhimi i pemëtarisë
5. Do të ndihmohet në dokumentacionin e pronësisë e cila do të krijojë mundësi kreditimi si dhe financime nga donatorë ndërkombëtarë
6. Do të sigurohet një mbështetje e specializuar në prodhimtarinë e fermerëve
7. Do të ofrohen lehtësi për sigurimin e tregjeve
8. Do të synohet rritja e sigurisë ushqimore nëpërmjet mbështetjes për ngritjen e fermave biologjike si dhe mbështetjen për ato ekzistueset nëpërmjet nxitjes së prodhimeve organike/produkteve bio
9. Do të orientohen fermerët drejt prodhimit të kulturave tipike për të cilat ka dhe një traditë vendase
10. Do të ndahen tregjet sipas produkteve specifike, në mënyrë që të respektohen kushtet e higjenes dhe t'u shërbehet me standarde të larta qytetarëve
11. Do të krijohet markatë e re për prodhimet e detit
12. Do të krijohen tregje për të ofruar cilësi dhe shërbime, në Llakatund

Fusha: TRANSPARENCA

Premtime:

1. Për herë të parë në Vlorë do të aplikohet votimi elektronik, një formë e komunikimit me qytetarët, ku do të merret mendimi i tyre për çdo projekt apo ndryshim në Vlorë
2. Banorët do të jenë të përfshirë në vendimmarrje; Çdo lagje e Vlorës do të ketë studimin e saj urbanistik, i cili do të bëhet publik dhe do të paraqitet në komunitetin përkatës për t'u shtruar diskutimeve, sugjerimeve apo edhe vërejtjeve të banorëve, më pas do të hartohet projekti përkatës, duke patur parasysh propozimet e ardhura nga komuniteti dhe pasi të jenë bërë të gjitha llogaritjet inxhinierike dhe monetare të nevojshme, do të kalohet në fazën e zbatimit
3. Do të ketë transparencë publike për çdo vendimarrje
4. Do të zhvillohet një portal unik për shërbimet

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Premtime:

1. Do të krijohen kushte dhe infrastrukturë për personat me aftësi të kufizuar
2. Do të ndërtohet qendra ditore për të moshuarit

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Do të ketë mbështetje për çdo biznes që gjeneron vende të reja pune dhe ndihmesë për shërbime në të mirë të qytetarëve
2. Do të zbatohen politika që nxisin zhvillimin e qendrueshëm të ekonomisë me mbështetje dhe lehtësi për biznesin e vogël
3. Do të krijohen lidhje dhe do të ndikohet në qeverisjen qendrore për të patur më pak burokraci dhe drejtësi në ushtrimin e aktivitetit për bizneset e mëdha
4. Do të ofrohet punësim sezonal për familjet në nevojë
5. Do të punësohen më shumë gra dhe vajza
6. Do të kryhet trajtim i barabartë për mbledhjen e taksave dhe tarifave